



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 2, Datë 27.05.2014

PËR

MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR NDËRTIMIN E BY-PASS  
TË RROGOZHINËS

Në mbështetje të neneve 70/8 dhe 70/11 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, të VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për ndërtimin e By-Pass të Rrogozhinës, me një gjatësi rruge prej 4.3 km, që shtrihet duke filluar nga rreth-rrotullimi ekzistues i Rrogozhinës dhe përfundon në kryqëzimin e fundit në rrugën ekzistuese Rrogozhinë – Elbasan.
2. Materiali i plotë grafik bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA




ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI



MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



Z. EDMOND HAXHINASTO

MINISTËR I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

